



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Dëgjesë Publike

“ Mbi PBA 2024 ÷ 2026 dhe Projekt Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 “
Në Rajonin Nr 1. (Ora 16.30)

Marrin pjesë :

Kryetari i Bashkisë z.Ermal Dredha; Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj.Elpinqi Mërkuri;
Zëvendëskryetarë të bashkisë; Sekretari i KB; Anëtarë të Këshillit të Bashkisë ; Drejtorë
drejtorish dhe institucionesh të bashkisë ; Kryetari i rajonit; Banorë të rajonit; Shoqëria civile.

Z.Ermal Dredha/Kryetar i Bashkisë - Përshëndetje të gjithëve!

Jemi mbledhur, në fakt është takimi i pestë sot, nëpër njësi e rajone për të zhvilluar dëgjesat
publike . Jemi duke hartuar Projekt-Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024.

Po e filloj me investimet që ka bërë Qeveria Shqiptare, jo nga bashkia, sheshi në qendër.

Një lajm tjetër i mirë , në sajë të marrjes së investimeve, kemi marrë dakortësinë nga FSHZH,
për investimin në 10 rrugë; Në këtë rajon., përfshirë dhe rrugën e spitalit. Kemi marrë
dakortësinë për veshjen e pallateve, fasadën e gjithë pallateve. Kemi marrë dakortësinë, do fillojë
shumë shpejt. Ujësjetësi ka bërë ndërhyrje. Do të flasë zonja Elona, në lidhje me përfundimin e
projektit të ujësjetësit.

-Rruga e “Karabashit “, do bëhet asfaltimi, kanalizimet janë bërë. Brenda lagjes “Karabash”,
morra dijeni nga qytetarë për një segment 200 m. Do ta shohim me FSHZH.

Jam këtu dhe për të dëgjuar ju.Edhe pjesa e vendosjes së koshave , do shohim dhe pjesën e
brendëshme të lagjeve , do ti evidentojmë.

Z.Hiqmet Haxhaj /DFBK – Zhvillojmë këto dëgjesa publike për të marrë mendimin tuaj, për
hartimin e projekt buxhetit për vitin 2024, PBA 2024÷2026.

Në Total – 2,659,506 mijë lekë (2 miliard 659 milion 506 mijë lekë)

Granti i pakushtëzuar – 710,738 mijë lekë (710 milion 738mijë lekë)

Granti specifik – 447,452 mijë lekë (447 milion 452 mijë lekë)

Të ardhurat nga burimet e veta -1,501,312 mijë lekë(1 miliard 501miljon312 mijë lekë)

Investimet – 377,748 mijë lekë(377miljon 748mijë lekë)

Shpenzimet : Në PBA , prioritet në Rajonin Nr 1, është rikonstruksioni i palestrës së shkollës “4 Heronjtë “

-Ndërtimi i rrugëve, trotuarëve, -250 miljon lekë, për gjithë rajonet, përfshirë këtu dhe Rajonin Nr 1. Këto janë disa nga treguesit kryesorë të buxhetit për vitin 2024.

Presim sygjerimet, mendimet tuaja . Fondi prej 250 miljon lekë/reja për lulishte, rrugë, trotuarë, ku $1/5 = 50$ milojnë për Rajonin Nr 1.

Z.Ermal Dredha – Projekzioni ..

Z.Hiqmet Haxhaj – dhe kërkesat e banorëve janë të rëndësishme, të shohim dhe të vendosim.

Znj.Anjeza Shiko /DAV – Nga pozicioni, Rajoni Nr 1 , ka një numër të vogël të bizneseve.

Realizimi shkon në 70% nga bizneset, të ardhura këto që kthehen në investime për qytetarët.

Bashkia ka në fokus shërbimet për qytetarët.

Znj.Elona Hodaj /SHAUK - Është projekti, ka përfunduar. Është 1 familje nuk na lejon për përfundimin e depos së ujit.

Z.Edmond Leka /NDSHP- Ka mungesë të kontenierëve . Do ti'a kërkojmë këshillit të bashkisë , ti shtojmë ...

Z.Flamur Habilaj /banor – Ne përfaqësojmë zonën mbi spital. Rruga që tha kryetari që do bëhet, na pëlqen. Zona mbi spital, problemi i ujit të pijshëm, duhet të vinte në muajin qershor.

Infrastruktura, thuajse është e ngritur.

Rruga “ Bilbil Ceno”, infrastruktura është në rregull, vetëm asfalti mungon.

-Tek kinemaja , të merren masa , të dizinfektohet .

-Ndriçimi, mungojnë llampa në rrugën “Bilbil Ceno “ Është shqetësim nga komuniteti. Më pëlqen programi i buxhetit. Suksese !

Z.Sami Likaj / banor - Faleminderit që na mblodhët. Problem , është rruga tek shtëpia ime , të futet te legalizimet. Të vihet në urbanizim.

Z.Ermal Dredha – Projekzioni me ndryshimin e tarifës së ujësjellësit.

Znj.Elona Hodaj – Është bërë kërkesë për ndryshimin e çmimit të ujit të pijshëm. Janë shumë projekte, 100% në zbatim deri në fund të muajit dhjetor. Do të ketë rritje të çmimit të ujit, për kryerjen e këtyre investimeve. Jemi një nga qytetet e vetme me këtë çmim, do bëhet nga 45÷60 lekë.

Z/Meço /banor i lagjes “Hajro Çakërrri”- rruga “Herbert”, rreth 500 m, e pa bërë. Kanalizimet janë shtruar, mungon vetëm asfalti.

Z.Ermal Dredha – Do ta bëjmë, premtim për vitin 2024.

Z.Jeto Hajdini/banor – Përballë ish kinemasë “Ali Demi . përgëzime për organizimin dhe për heqjen e mbetjeve. Tek kinemaja, gropës me kallamishte i bëni derman.

Z.Ermal Dredha – Nuk është prona jonë. E kemi pastruar.

Z.Jeto Hajdini – Tek pallati nr 512, s'ka kanalizime, përmytje nga shirat.

Z.Geron Gunbardhi/Anëtar i KB – U thatë çmimin e ujit, në lagjen ku s'ka ujë, do rritet çmimi.

-Në lagjen “Karabash” hapni rrugën të kalojnë .

-Lagjia "Partizani" që lidhet me lagjen "Llonxhë", nuk ka ujë. Këto janë lagje të rajonit. Kthejuni shikoni pak, rrugët po zihen, përfshi dhe lagjen "Topana". Nuk ka ndonjë afat të zhvillimit të punimeve.

-Tek sheshi para bashkisë, ndonjë zgjidhje për parkimin e furgonave. Janë bërë shumë punë, rrugë, të hapet rruga e trenit.

-Për ujin...këto janë situatat. Sa do të rritet çmimi i ujit?

Znj.Elona Hodaj – Në rang republike, jemi qyteti me çmimin më të ulët, nga 45 lekë do të bëhet 60 lekë.

Znj.Edlira Kapllanaj /Anëtare e KB – Falënderoj gjithë pjesëmarrësit. Faleminderit që mbajtët premtimin elektoral në buxhet, për rikonstruksionin e palestrës në shkollën "4 Heronjtë", është në dobi të rinisë.

-Përshejtoni projektin e ujit të pijshëm, në lagjen "Llonxhë"

Znj.Elona Hodaj – Jemi takuar dhe me firmën, pengesë është një qytetar, i cili pengon projektin për bërjen e depos.

Z/ Banor i rajonit – Jemi 17 familje, shumë problem pusetat. I kemi bërë kanalizimet vet.

Znj.Elona Hodaj – Vetëm po të bëhet projekti, ne nuk jemi për investime, vetëm për riparime.

Z.Devoll Likaj / banor – Rruga në zonën e Kuzum Babasë, kanë vënë një tubo, familja Duka, që kur ishte firma "Duka" që derdhen ujrata. Kam kërkuar të hiqet tubua, ka ngelur e mbuluar...Mbytemi, është një kanal rreth 8 m.

Z.Zambak Selmani /DIIP- Është investim i ujësjellësit, jo i bashkisë, dhe as nuk e monitorojmë ne. Unë monitoroj, investimet e bashkisë, jo të ujësjellësit.

Znj. Elona Hodaj – Zoti Devoll, familja Duka ka bërë një kanal. Ujësjellësi ka shkuar, e zgjidhëm..., Adhurimi nuk pranon ta heqë. Është çështje midis zotërinjve Adhurim dhe Devoll.

Z.Ermal Dredha – Do ta zgjidhim.

Z.Simbol Pazaj/Anëtar i KB – Faleminderit për takimet që organizoni.

Besoje se anëtarët e stafit tuaj, do ndajnë të njëjtin shqetësim për zonën e Çimentos, pjesa më e pazënë me dorë. Kam 2 herë përgjegjësi. Nuk do më vinte mirë mos të vihej në buxhetin e vitit 2024 kjo zonë me shumë problematika si, rrugët, trotuarët, ndriçimi, uji i pijshëm.

Z.Qemal Kasaj /banorLagjia "Partizani" - Po flitet për infrastrukturë. Gjatë fushatës na u premtua, për një urë, të bashkohet lagjia. Tek fundi i rrugës "Bilbil Ceno" është një përrua.

-Ndriçimi, disa shtylla nuk janë vendosur.

-Ujrata e bardha nga rruga e trenit, më vijnë tek dera. Nuk kam marë zgjidhje.

-Të bëhet një fushë me rrjetë për të rinjtë, të merren me sport.

Z.Ermal Dredha – Mos keni zaptuar ndonjë tokë, e keni legalizuar. Do shohim ku ka hapsira të lira, do shohim mundësinë për të bërë lulishte, ndonjë fushë sporti...

Z.Zaim Bergaj /banor – Rruga e vajgurit është shumë problem, pa ndriçim, është rruga "Sofi Arapi"

Z.Ermal Dredha – Ka gjendje, pa pritur buxhetin. Ka llampa, javën tjetër me ndriçim.

Z.Banor /Rruga "Herbert"- Bëri projektin ujësjellësi, rrugët kanë ngelur të prishura, tubat sheshit.S'është vënë dorë.

Znj/Banore e rajonit – Për arsimin , faleminderit që po zbatohet projekti për palestrën e shkollës “4 Heronjtë”. Ka shumë fëmijë të talentuar, presin përfundimin e palestrës. Është arsimi një herë, përkrah gjithë shqetësimeve të tjera.

Z.Ermal Dredha - Pak a shumë i dimë shqetësimet . Janë të shumta. Ne do fillojmë një nga një , ato më të prekshmet , sa kemi mundësi deri në fund të mandatit. Ato që janë të prekshme , me fonde të vogla. Palestra do të bëhet vitin e ardhshëm. Kemi bërë rikonstruksionin e palestrës së shkollës “Lef Sallata “, nga përvoja , ndryshon ..

Rrugët e brendshme të lagjeve, do të bëhen sipas mundësive.

-Projektet për mbylljen e rrugëve, do ta ndjek vet me kompaninë....pak a shumë. Na keni në dispozicion. Jemi për shërbim në komunitet. Çdo kërkesë nga ju, do të shkojë në çdo drejtori , kemi të pranishme dhe zonjën Irena, zëvendëskryetaren e bashkisë.Jemi në dispozicionin tuaj. Shpresoj të bëj më të mirën për ju në vazhdim.

Faleminderit !

Vlorë, më 11.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Dëgjesë Publike

“ Mbi PBA 2024 ÷ 2026 dhe Projekt Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 “
Në Njësinë Administrative Orikum. (Ora 17.00)

Marrin pjesë :

Kryetari i Bashkisë z.Ermal Dredha; Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj.Elpiniqi Mërkuri; Zëvendëskryetarë të bashkisë; Sekretari i KB; Anëtarë të Këshillit të Bashkisë ; Drejtorë drejtorish dhe institucionesh të bashkisë ; Administratori i njësisë; Banorë të njësisë; Shoqëria civile.

Z.Selim Haskoçelaj/Administratori i njësisë - Siç e dini, nga takimet që kemi bërë nëpër fshatra, në lidhje me hartimin e projekt buxhetit të vitit 2024. Pra, bëjmë këtë dëgjesë publike në lidhje me problematikat shqetësimet që keni. Të pranishme kemi dhe kryetaren e këshillit, zonjën Elpiniqi Mërkuri, pasi këshilli mbikqyr punën e administratës.

Znj.Elpiniqi Mërkuri/Kryetare e KB – Faleminderit që keni ardhur. Jemi të interesuar për këtë njësi, e cila është fokus i qeverisë dhe Bashkisë Vlorë.

Ju lutem specifikoni problemet tuaja. Zoti Selim ka dhënë informacion të saktë në lidhje me problematikat e njësisë. Edhe ne si këshill bashkiak, do të kemi në fokus gjithë investimet për këtë njësi.

Z.Hiqmet Haxhaj/DFBK - Organizimi i dëgjesave publike, bazohet në Udhëzimin e Ministrisë së Financave....ky raport i hartuar i shkon ministrisë së financave dhe zbatohen rekomandimet për përgatitjen e PBA 2024 ÷2026 dhe dhe projekt buxhetin e vitit 2024, bazuar këto dhe në Ligjin Nr 139/2015.

Bashkia Vlorë, është bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor .

Treguesit kryesorë të PBA 2024 ÷ 2026,

Për vitin 2024 – Totali i të ardhurave 2,659,506 mijë lekë (2 miliard 659 milion 506 mijë lekë)

Granti i pakushtëzuar – 710,738 mijë lekë (710 milion 738mijë lekë)

Granti specifik – 447,452 mijë lekë (447 milion 452 mijë lekë)

Të ardhurat nga burimet e veta -1,501,312 mijë lekë(1 miliard 501miljon312 mijë lekë)

Investimet – 377,748 mijë lekë(377miljon 748mijë lekë)

Shpërndarja e shpenzimeve :

Për vitin 2024 – 608 miljon e, të përfshira këtu ,

- shërbimi zjarrfikëses ,

-ujitje – 53 miljon ...

-pyje , kullota ,

- rrjetin rrugor – 135 miljon e ...

-menaxhimi i integruar i mbetjeve – 417 miljon e ...

-shërbimet publike - 450 miljon

-shërbimet sportive – 75 miljon

-arsimi i përgjithshëm – 73 miljon

-përkrahja sociale – 30 miljon

Investimet – 3 miliard 762 ...për 3 vjet.

Njësia Orikum – 38 miljon , përfshirë këtu

-Rikonstruksion i rrugës në lagjen Kodër,Orikum.

-Rruga për tek kisha e Marmiroit

-Shëtitorja e Tragjasit. Në Total- 430 miljon lekë/vjetra, pa përfshirë investimet nëpër shkolla.

Këto nga të ardhurat tona.

Për arsimin, 250 miljon lekë, për gjithë bashkinë, përfshirë këtu dhe njësinë Orikum. Këta janë pak a shumë . Presim pyetjet dhe diskutimet tuaja.

Z.Mezin Ramohito /Tragjas – Problemtaikat janë të shumta. Zona ka qenë jashtë vëmendjes së bashkisë..Nëqoftëse, do realizohen këto që dëgjuam, shumë mirë, por nëqoftëse , janë kështu kot...

-Problem , ndriçimi në Tragjas në :

-Rrugën “Zonja Çurre” dhe rrugën “ Neim Dano “

Përsëritje dhe suksese zoti kryetar(vjen KryetariZ.Ermal Dredha)

Loti III, rruga e Tragjasit . Më shumë se 70% e fshatit , pa rrugë, dhe ato që janë janë të amortizuara, nga projekti i ujësjellës – kanalizime .Shpresojmë ,.. kjo zonëka shumë biznese, paguajnë taksat .

Z.Meladin Sulo/Tragjas – Ju falënderoj për angazhimet e thëna. Jo më shume se 5 muaj, mblihdemi për të analizuar problematikat tona. Premtimet po i mbani. Ka investime për Tragjasin.Falënderoj dhe zotin Selim, nuk ka të majtë e të djathtë .

Z.Arsen Belaj – Anëtar i KB - Projektbuxheti fillon me të ardhurat , shpenzimet dhe investimet. Prandaj, duam të dimë çfarë është bërë dhe më vonë, çdo të bëhet për këtë vit. Flas si qytetar, është shqetësim i të gjithë banorëve, është lënë pas dore për 8 bjet.

-Investimi kryesor të jetë tek dritat, ndriçimi,

-era e mbeturinave

-mushkonjat i kemi shumë problem.

Do të doja që buxheti të shpërndahej në mënyrë faktike . Të bëhet një rishpërndarje, su dëgjua as për Dukatin, Orikumin, Radhimën. Tragjas – Orikum, ka shumë probleme, këtu nuk vete çdo gjë vaj.

Z.Ermal Dredha – Ne pranojmë kritikën dhe sygjërimet. Patjetër që ka për të bërë më mirë, prandaj bëjmë dëgjesta të marrim kërkesat tuaja.

Janë disa projekte të qeverisë shqiptare

-Rruga e fshatit Radhimë, Kopshti -430 milion lekë , do të segmentohet

-Projekti për rrugët e brendshme të Orikutit

Jemi të kënaqur? S’ mund ta them. Ka shumë projekte nga qeveria. Sot gjendja ka ndryshuar. Do të ketë investime në infrastrukturë. Loti III , Tunel- Radhimë dhe reaksion negativ për pronarët. Do shohim më të mirën për komunitetin, do bëhen shpronësimet..., Buxheti i Bashkisë Vlorë , shpronësimet me çmimin e tregut.

Jemi këtu për të dëgjuar dhe të bëjmë çdo mund të bëjmë. Çfarëdo loj ndërtimi që të ketë qytetit, është taksë e infrastrukturës. Do bëjmë gjëra të mira, mos ta nënvlerësoni çka është bërë në këtë zonë. Në Dukat Fshat, rruga nuk është në buxhetin e bashkisë, por do kontaktojmë me ARSH

Z. Sulo – Mbeturinat..., rruga e Vlorës është shumë problematike .

Z.Ermal Dredha – Me investimet strategjike të qeverisë, me by-pass...Jemi këtu për të investuar.

Z.Lefter Leka /Orikum – Falënderoj Kryetarin e bashkisë, kryetaren e këshillit bashkaik dhe zotin Selim për takimin e sotëm. Pastrimi është bërë. Investimet ,

Ujrat nga fushë Dukat, të bëhet një mur, rrezikohen banesat në lagjen Kodër – Orikum . Prandaj, është urgjente. S’është bërë gjë.

Z.Foto Gjipali /banor – Nuk është investuar për asgjë. Kemi kanal në mes të fshatit , shkollën

Z.Muharrem Jaze – Kam besim tek ai projekt për zonën tonë. Do të doja të kishte më shumë qytetarë. Do të thosha, janë bërë shumë projekte..., ju si bashki keni përthithur projekte , përse mos të investohet në rrugët dytësore?

-Problemi i dritave, Projekti i ujrave të zeza, është në shumë faza..., filloi projekti prapë. Kur do të bëhet funksional. Pa mbaruar në Dukat, filloi në Orikum. A ka ndonjë audit që kontrollon këta që zbatojnë projektet ..Pse mos të ketë bashkia.

Z.Selim Haskoçelaj - Këtë e kontrollon gjermani. FSHZH me KËF kanë projektin. Të mbarojnë ujrat e zeza , pastaj asfaltimi i rrugëve. Jemi futur në projekt për ujësjellësin, 50 milion lekë.

Z.Arsen Belaj – Të flasim për problemet që hasim ne, realet. Dukati, fshat Dukat , radhimë...

Z.Valter Hasanaj – Projekt buxheti, është diçka shumë e rëndësishme. Kërkojmë , të marrë gjithësecili për zonën e tij.

Rruga e Radhimës, është buxhet për 3-4 vite, të ketë një vëmendje të madhe. Është i vetmi fshat që nuk ka rrugë, Radhima .

Z.Ermal Dredha – Është bërë projekti. Është në procedurë prokurimi.

Z.Valter Hasanaj – Jemi një vend turistik, ashtu si në Vlorë dhe Orikum , që kanë stacionet.

Bashkia të shohë me përparësi vendqëndrimin e autobuzëve, taksive .

Orikumi, e meriton së pari, që të ketë ndriçim, sikurse të gjithë. Ka lagje pa ndriçim.

-Rruga tek varrezat në Radhimë....gjithëçka e kemi bërë vetë. Ka ngelur 100 m rrugë për tu bërë.
Z.Zambak Selmani/ DIIP – Na i sillni pikat dhe oraret dhe ne do bëjmë një projekt.

Z.Ariz Kapo/Orikum – Prioritet , shëtitörja e Tragjasit , Kisha e Marmiroit dhe lagjia tek Kodra, e Orikumit.

Pastrimi i hapsirave publike, oborreve, gardheve.

Buxheti goxha për bujqësinë. Të ndihmohet bujqësia, tpastrohen kanalet

Kam 25 vjet që e mirëmbaj rrugën prej 1,5 km , tek parcela.

Z.Hiqmet Haxhaj - përsa i përket fondeve për kullimin ..., përfshihet dhe njësia juaj.

Z.Sherif Durmishi /Radhimë – Do të shtoja për Kishën e Marmiroit, ka efekte shumë frytëdhënëse.Ti kushtohet rëndësi sportit.

Të ishin të pranishëm më shumë biznese . Ne paguajmë taksat. Kur krijohet një buxhet i plotë, flasim më mirë. Radhima, një segment lidhet me aksin kryesor të rrugës. Pjesa tjetër, bujqit që kanë tokën , duhet bërë një mbikalim/nënkalm, për të kaluar. Ju uroj punë të mbarë.

Z.Arsen Belaj – Përveç fshatit Radhimë , rrugët e fshatrave të tjerë, janë bërë , por duhet të mirëmbahen.

-Rruga kur shkon për tek deti, ka ngelur një pjesë pa shtruar, nuk e di kujt i takon. Janë 500m.

-Duhet vëmendje për institucionet arsimore., shkolla e Dukatit, shkolla e mesme Orikum, s'kanë nxënës .

A ka ndonjë koefiçient. E ka kryetari i bashkisë të kontaktojë me Drejtorinë Arsimore. Bëni shkollën e mesme në Dukat dhe Orikum.

Z.Ermal Dredha – Ju falënderoj dhe kërkoj ndjesë për vonesën.

Ideja është , po i referohem zotit Muharrem, që ka më shumë administratë. Ligji i detyron të jenë këtu për të dëgjuar dhe kthyer përgjigje diskutimeve tuaja, si të bëjmë më të mirën për projeksionin e buxhetit të vitit 2024. Të bëjmë çtë mundemi...murin do ta bëjmë, për

Llandfilldin, u firmos projekti, është për të mirën e komunitetit. Ne e anulua kontratën me atë investitor. Besoj do zgjidhet shpejt ajo punë.

Faleminderit.

Vlorë, më 10.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Dëgjesë Publike

“ Mbi PBA 2024 ÷ 2026 dhe Projekt Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 “
Në Rajonin Nr 5. (Ora 16.30)

Marrin pjesë :

Kryetari i Bashkisë z.Ermal Dredha;Zv Kryetar i Këshillit të Bashkisë z.Novrus Rrokaj;
Deputete znj.Teuta Rama; Zëvendëskryetarë të bashkisë; Sekretari i KB; Anëtarë të Këshillit të
Bashkisë ; Drejtorë drejtorish dhe institucionesh të bashkisë ; Kryetare e rajonit ;Banorë të
rajonit ; Shoqëria civile.

Znj.Brisilda Çobaj /Kryetare e rajonit – Ju faleminderit që keni ardhur në këtë takim, për
hartimin e projektbuxhetit , për vitin 2024.

Rajoni ynë ka 30 mijë banorë, dhe e kthyer në familje 9700 familje. Rajoni ka prbleme me
infrastrukturën. Ta shohim si një bashkëbisedim me njëri tjetrin, por pa lënë , pa përmendur dhe
punën e mirë që është bërë.

Z.Ermal Dredha /Kryetar i bashkisë – Është takimi i 6-të në radhë.., E parashikon ligji, dëgjesat
publike, në lidhje me projekt buxhetin. Kemi hartuar një projekt buxhet edhe pse ka qenë vit
elektoral. Problematika ka , është zonë që nuk është vënë dorë prej vitesh. Mungon
infrastruktura. Kemi çuar projekt për kanalizimet.

Si bashki me FSHZH, kemi arritur të marrim dakortësinë për rehabilitimin e fasadave të vjetra,
50 ndërtesa. Është një proces i plotë, i cili ka të bëjë më shumë me lëvizjen e boljerëve. Është një
bulevard i mirëfilltë. Pjesa e asfaltimit dhe riasfaltimit, do jetë prioriteti ynë. Kemi marrë dhe
dakortësinë nga FSHZH për riasfaltimin e 10 segmente , rrugë të qytetit, përfshirë këtu dhe nga
Rajoni Nr 5.

Kjo është dëgjesë publike, dmth atë projeksion që kemi ne si bashki, ta ndajmë në mënyrë të
barabartë. Të pranishëm kemi dhe drejtorin e financës.

Z.Hiqmet Haxhaj /DFBK – Vijnë në dëgjesë publike, për të marrë mendimet tuaja, për hartimin
e projekt buxhetit ët vitit 2024., por bazë për këtë është PBA 2024- 2026. Treguesit bazë , janë :

Të ardhurat në total – 2,659,506(2miljard 659 mijë)

Shpenzimet , janë në administratë, shërbimin zjarrfikës, ujitje, kullim arsim, etj. Në kuadër të këtyre;

Investimet për vitin 2024, parashikohen në masën 377,748 mijë lekë.

Prioritetet për Rajonin Nr 5;

-Rehabilitimi, rikonstruksioni i lagjes “Kushtrimi”, 100miljon lekë.

-Rikonstruksioni i rrjetit tercial, të ujrave të zeza.

-Investimi në rrugë, trotuarë, lulishte, në Total, për gjithë qytetin 250 miljon lekë, pra për rajonin Nr 5 , 1/5 = 50 miljon lekë.

Janë goxha investime për Rajonin Nr 5.

Z.Klaudio Mehmetaj/Dr.Urbanistikës – Në vijim të investimeve , për fasadat e pallateve , në lidhje me FSHZH të kemi marrë dakortësinë, deri tek “Rruga e Paqes “

-Sistem qëndrëzimi, për boljerët. Në bashkëpunim me FSHZH, fond për rikonstruksionin e rrugëve, tek fusha e Aviacionit. Jemi duke hartuar një projekt ide, për pjesën para shkollës “Halim Xhelo “

Znj.Elona Hodaj/SHAUK – Është i vetmi rajon që nuk ka investime në rrjetin e ujës-jellë – kanalizime.Në të gjitha lagjet, është një ngarkesë..Ne si ndërmarrje jemi riparimi, jo investimi . Në burim, pika kryesore të furnizimit, është problem. Duhet vënë në funksion pika prodhuese në Pus Mezin. Investimi që do bëhet, është marrë “ok”, është rrjet i amortizuar, ka lidhje të jashtme. Jemi duke rakorduar me banorët, fillon investimi në Pus Mezin. Është problem rrjeti ujës-jellës-kanalizime

Depozita, është projekti për tu vendosur nëndhe, do hiqet fare kur të mbarojë projekti.

Z.Niko Zharra – Për atkimet tuaja zoti kryetar, çdo të enjte, të zbatohet pritja e qytetarëve.

-Administrata është në nivel të dobët, të presin me indiferentizëm.

Z.Ermal Dredha – Që kur kam filluar punë, kam pritur nga 40-60 qytetarë ,ditët e enjtedhe kur lëviz , kam angazhime zyrtare. Unë pres me orar pa orar.

Është një zëvendëskryetar për këtë punë, për të pritur qytetarët, për ju, për problematikat tuaja. Pra, dera nuk është mbyllur. Nuk egziston ky term. Unë mendoj të jemi pak më praktikë. Është e pranishme dhe zëvendëskryetarja, zonja Irena, për të pritur dhe dëgjuar kërkesat, ankesat tuaja. Jam i bindur që do të funksionojë.

Z.Petref Hoxha /Banor

Është shtruar një rrugë. Janë shumë familje që do vijnë tju falendrojnë

Shohim pastrim shembullor

Sa për prezencën e administratës, administrata është në vendin e punës.

Deputetet dhe shumë të tjerë, administrata e rajonit kanë qenë shumë të mobilizuar dhe nga ndërmarrja e ujës-jellësit këto 200 familje janë të kompletuara.

Të falenderohet dhe administrata.

Problem është kanali që shkarkon në veri të serave, ka 10-15 ditë që është mbyllur fare . Është harruar, ai shkon në hidrovor.

-Janë disa familje që derdhin ujrat e zeza

-Rruga “Bektash Cakrani “, burim aksidentesh, duhen prishur ato cepat.

Z.Edmond Leka/NSHP – Nuk është vetëm ai kanal, ka lidhje dhe me rajonet e tjerë. Kemi shkuar me inxhinierin. Zotëria ka shtëpinë dhe gardhin në buzë të kanalit.

Z.Qemal /Banor – Falenderimet , merrini si më shumë përgjegjësi. Jemi të gjithë të ardhur në këtë zonë. Ndihehi pak të mënjanuar. Tek fusha e Aviacionit – Kastrati ,

-Rrruga shumë keq, pa trotuarë

-Ndriçimi vende-vende

-Kanali është pastruar shpesh, por hidhen inerte.

Z.Ermal Dredha – Ju lutem, të dëgjojmë njëri tjetrin, çka mund të bëjmë. S’jam këtu për të gënjyer.

Z.Banor /Ish Fabrika e Tullave – Zotëria foli për administratën. Ne atje ku shkojmë, të rrespektohem.

Kemi kërkuar takim për ujin e pijshëm. Faleminderit që vini dhe na takoni.

- Problem është uji i pijshëm

-Rruga, kanalizimet janë shumë urgjente. Ktheni vështrimin dhe nga lagjia jonë, uji ka shkuar kudo nëpër lagjet e rajonit.

Z.Ermal Dredha – Ajo zonë do rikualifikim

Z.Banor/Ish Fabrika e Tullave – Bëhet dallim për disa familje. Të hapet kanali, të shtrohen tubacionet. Drejtoresha më ka pritur.

Znj.Liri Shkurti/Banore ”Osman Haxhiu “- Rruga e lagjes “Lirim “.., njerëzit duan rrugë spitali. Problem i madh është , nuk kalon as zjarrfikësja as ambulanca.. Jam shumë e kënaqur nda drejtoresha e ujësjellësit. Pati difekt, u rrgullua, tani të mbuloheh , të mbyllen. Jam banore në lagjen Vrenez. Të shtrohet rruga nga Vrenezi.

Ka pallate me shumë probleme, po amortizohen, po të bëhet ndonjë ndërtim apo rikonstruksion dhe, të strehoen këta banorë.

Z/Banor – As drita, as rrugë. Na mbuloni kanalën, ka shumë mushkonja.

Z.Ermal Dredha – Gjithë kjo zona juaj, do 3miljon lekë. Do marrim ekspertë për kanalën. Nëse lejohet të mbuloheh, do të mbuloheh.

Z.Tili /Banor – Edhe unë problemin e kanalit do të ngre.

Z.Edmond Leka – Kemi shkuar, e kemi pastruar kanalën vetëm në një krah, pasi nuk lënë të prishet murri.

Z.Qatip /Banor – Kryetare e rajonit , na ka pritur. Falënderoj dhe drejtoreshën e ujësjellësit, pusët na u rregulluan. Na është përgjigjur.

-Problemi i shtëpive, pa marrë certifikatën e pronësisë. Fëmijët janë të larguar, kemi bërë kontakte, kemi paguar taksat. Ajo është pasuria ime. Si do shkojë ky problem.

Z.Ermal Dredha – Përgjegjëse është ASHK dhe jo bashkia .

Z.Bekim Biba – faleminderit për organizimin e këtij takimi.

-Problem është lagjia tek “Elektriku “

-Falënderoj SHAUK. Kemi ujë të pijshëm. Gangren është problemi i ujrave të zeza, ndriçimi i rrugëve ka ndryshuar.

Nuk kemi rrugë, asfaltim. Do na e planifikoni ?

Z.Klaudio Mehmetaj – Zonën tek “Elektriku “, e ka FSHZH .

Z.Banor – Rruga “Kanina” është e bllokuar. Banojmë aty rreth 30-40 familje.

-Problem uji i pijshëm dhe ujrat e zeza.

Znj.Endora Çelohoxhaj/Lagjja “Hysni Muka “ - Asfaltimi mungon, është zonë e diskriminuar

-Ndriçimi, shumë problem, nga stacioni i fundit deri në Pus Mezin

-Kanalizimet e ujrave të zeza dhe pusetat shumë problem. Folën shumë banorë për mirë.

-Të ketë rrugë për zjarrfikësen dhe ambulancën në lagjen tonë. Po flas për një buxhet, sektorin e mjedisit që nuk po ndihet. Ku është rinia, nuk po ndihet ?

Z.Kastriot Meja – Kemi bërë takim tek lagjja “Kushtrimi “. Në lidhje me banesat sociale, çfarë u bë ?

Z.Ermal Dredha – Kemi pas presion dhe nga EKB për ndarjen e godinës, banesës sociale. Do aplikohet me 2 faza. Janë 75 banesa . Nuk ka pas komision për vlerësim pas aplikimit. Pra, , është sistemi i pikëzimit, pra, duke filluar që nga të ardhurat , nuk është shtëpi që jepet falas. Kanë aplikuar dhe nuk plotësojnë kriteret. Pra, në këtë mënyrë nuk mund të shkojmë në këshill. Do bëjmë një verifikim për të gjitha dosjet, ta bëjmë si duhet këtë punë. Duam të jemi korrekt. Prandaj, lista do reduktohet, selektuar, që të kenë plotësuar kriteret.

Z.Kastriot Meja – Rruga që bashkon Transballkaniken me ...

Z.Ermal Dredha – Këtë herë në këshill do kalojë sistemi i pikëzimit.

Z/Banor – Jeni i pari që na keni mbledhë këtu. Problem rruga, a do të bëhet ? Po kanali do pastrohet ?

Znj.Elona Hodaj – Çdo fillim vjeshte, ne bëjmë pastrim kanali. Ata e kanë me njëri tjetrin, banorët ia bllokojnë njëri tjetrit.

Z.Ermal Dredha – Do bëjmë maksimumin ta rregullojmë atë zonë . Ajo zonë ka qenë fidanishte, është ndërtuar sipas qejfit, për të qenë i sigurtë. Do bëj maksimumin. Ai investim është 3miljon euro, është zhvillim i FSHZH.

Z.Bastri/Banor – Rruga “Kanina “ , lagjja “Kushtrimi “. Janë bërë kanalizimet, toka është tjetërsuar, nuk kalojmë dot. Duam rrugë kalimi, jemi 20 familje . S’hyn as zjarrfikësja, as ambulanca.

Problem me ujin e pijshëm. Si do zgjidhet kjo punë ?

Z/Banor – Problemi i ujrave të zeza. Kanalizimet janë , duhen 10m tubo.

Znj.Brisilda Çobaj – Rikonstruksioni i zyrës së rajonit Nr 5 .

Vlorë, më 13.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Dëgjese Publike

“ Mbi PBA 2024 ÷ 2026 dhe Projekt Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 “
Në Rajonin Nr 2. (Ora 16.30)

Marrin pjesë :

Kryetari i Bashkisë z.Ermal Dredha; Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj.Elpiniqi Mërkuri;
Zëvendëskryetarë të bashkisë; Sekretari i KB; Anëtarë të Këshillit të Bashkisë ; Drejtorë
drejtorish dhe institucionesh të bashkisë ; Kryetari i rajonit ; Banorë të rajonit ; Përfaqësues të
bizneseve ; Shoqëria civile.

Z.Ermal Dredha – Përshëndetje të gjithëve !

Janë seanca dëgjimore , në lidhje me projekt buxhetin e bashkisë për vitin 2024. Është takimi i parafundit, përsa i përket takimeve për hartimin e projekt buxhetit 2024. Si fillim, është bërë prezantimi nga drejtori i financës me PBA me shifrat, jemi orientuar tek prioritetet. Do na flasë zoti Hiqmet.

Z.Hiqmet Haxhaj /DFBK – Vijnë në këtë dëgjese publike për hartimin e projekt buxhetit për vitin 2024. Presim mendimet dhe propozimet tuaja. Bazë për hartimin e projekt buxhetit, është PBA 2024 – 2026

Të ardhurat, në total – 2,659,506 (2miljard 659 mijë)

Nga të ardhurat e veta - 1,501,312 mijë lekë(1 miliard 501mijë312 mijë lekë)

Në projekt buxhet janë planifikuar për investime - 377,748 mijë lekë.

Për Rajonin Nr 2, kemi këto prioritetet:

-Ndërtimi i kopshtit në lagjen “Uji i Ftohtë “

-Projektin “Parkim publik “

-Trajtimi i ujrave të ndotur, përgjatë Lungomares.

Përveç investimeve nëpër lagje në kopshte, rrugë, lulishte. Presim mendimet tuaja.

Z.Ermal Dredha - Këto që do të them nuk janë në projektion, por kemi dakortësinë me FSHZH ,

- për asfaltimin e rrugëve në qytet .

Gjithashtu, rikonstrukcionin e palestrës “Flamurtari “; Pjesa e zonës së ish-Fabrikës së Çimentos,

-Projekti i lulishtes tek “Kali i Trojës “, por ka probleme pronësie. Do vazhdojmë ta implementojmë. Projekti është gati.

-Asfaltimi tek segmenti i shkollës “Ismail Qemali “

-Rruga tek shkolla “Tregëtare “. Nuk ishte planifikuar ndriçimi, por do ta bëjmë, mos të ngelet i cunguar. Për investime të vogla, do të jemi fleksibël...Pres mendimet dhe sygjerimet tuaja.

Z/Banor te rruga e “Lamanajve “ - Deri tek “Hanover” na vjen përroi.

Nuk ka asnjë shërbim.

-Problem janë rrugët.

-Kanali i madh, është bllokuar rruga tek “7 Pallatet “.Duhet pastruar.

-Tek ura e madhe është bllokuar.

-Problem, ujrat e zeza.

Z/Banor në lagjen /”10 Korriku “- Firma rregulloi rrugët e lagjes. Rruga deri tek fillimi i projektit, pa bërë 30 - 40m.

Z/Banor – Probleme sociale , me komshiun, i cili ka ndërtuar një kasolle, ju prish. Tani ka bërë një kanal. Po mbytem nga uji. Probleme të shumta kemi.

Problemi i rrugës, nga Psikiatria – Lungomare, rruga është shtruar, makinat kalojnë me shpejtësi. Të vihen tabela për kufizimin e shpejtësisë.

Z.Ermal Dredha – Për “policët e shtrirë “ janë parashikuar . Në momentin që do rregullohen rrugët do vihet dhe sinjalistika. Jam në bashkëbisedim dhe me Bankën Botërore.

Z.Kreshnik Tepelena – Problem , rruga “Dhimitër Konomi”.

Ujrat e zeza janë përzier me ujrat e bardha.

-Problem, parkimi në një krah. Kolaps për zonën.

-Për pjesën e Lungomares, parkimi publik, të jetë me pagesë, ti shkojnë të ardhurat bashkisë.

- Sporti...

Z/Banor - Në rrugën , mbi “Mira Mare” mungojnë koshat dhe ndriçimi.

Z.Ermal Dredha – Është detyrë funksionale e bashkisë. Kishte shumë mangësi, do shtohen. Është në projekt.

Z/Banor – Rruga mbi Shikun , është rrugë e pashtruar. Mungon ndriçimi. Mungojnë koshat . Të shikohen .

Z.Biznes/Hotel - Mbas shkollës “Ismail Qemali “, pa ndriçim. Rruga është e shtruar. Duam të shtojmë hotelerinë, por pa ndriçim.

-Sygjerorj, për rrugën Vlorë – Skelë, pengesë për qarkullimin janë stacioni tek rotonda në Skelë, nëse është e mundur të spostohet stacioni si dhe stacioni tek hyrja e tregut të orizit . Nëse do të shikohen, mos të pengohet, eliminohet trafiku.

-Turizmi të jetë gjithë vjetor.

Z.Ermal Dredha – Nuk ka lidhje me projekt buxhetin. Aeroporti i Vlorës, nuk është investim i bashkisë , por i qeverisë, por përfituesit jemi ne.

-Investimi tek "Marina" do të hapen vende të lira pune. Pra, të ketë të motivuar për punë, mund të vijnë fuqi punëtore dhe nga jashtë. Janë për tu parë në vazhdimësi. Buxhetet nuk mbulojnë gjithçka brenda vitit, por të bëjmë diçka dhe të mbetet.

Tek, Bar "Ini" po punohet, dhe kështu do të ndërhyhet në të gjitha lulishtet, në ambientet e përbashkëta për komunitetin.

Z.Arben Mexsi/ Arkitekt –Banor i rajonit – Faleminderit zoti Kryetar , që e mbajtët fjalën, që na thirrët në takim specialistë të fushave të ndryshme. Specialistë Vlora ka shumë, arkitektë, urbanistë artistë, juristë etj...Ju merrni mendime nga shumë specialistë. Kam qenë anëtar i këshillit bashkiak, i di fondet e bashkisë dhe të qeverisë. Zoti Kryetar, do të keni mbështetjen tonë. Shoh pastrimin, shumë mirë, ka ndryshuar.

- Problemi nr 1, mendoj që është parkimi. Me fillimin nga puna aeroporti, do të ketë shumë turistë, turizëm, por duhet të përgatitemi.

-Parkimet dhe rrugët , t'ia çoni një projekt qeverisë. Tre janë nyjet që pengojnë ; Rrapi, Tyneli dhe Kalaja. Do hedhur si projekt , të fillojë mbi "7 Pallatet"...

Mendoj se janë të domosdoshëm 3 parkime të mëdha, 1 në Ujë të Ftohtë, 1 parkim nëntokë dhe 2 mbi tokë. Projektet ti çohen qeverisë.

-Trafiku, shërbimi urban . Tre objekte janë për tu bërë në këtë rajon...kaq buxhet ka bashkia, kaq lekë ka. Duhet të liberalizohen lejet e ndërtimit.

-Ndriçimi mbi shkollën "Tregëtare".

Ju uroj suksese, jeni në rrugë të mbarë !

Z/Banor , specializuar për detin – Pikë e nxehtë , janë ujrat e zeza në Lungomare, të cilat derdhen në det.

-Duhet të ketë puseta, jo të derdhen në det. Nga Uji i Ftohtë , 5 pika të nxehta të firmës "Kamatakis" që bëri gjithë këto ndërhyrje dhe, në këto grykëderdhje , tek plazhi i "Medinit" me sistem kullimi.

Z.Ermal Dredha – Për menaxhimin e ujrave të zeza, Kryeministri përmend dhe përfshirjen , sa të marrë fund ky problem për gjithë vendin, do të ketë impakt tek investitorët , ka kosto.

Investimi do të bëhet nga ju për të shfrytëzuar vijën bregdetare. Do rëndohen xhepat e atyre që kanë hotelet. Kur të bëhet zyrtare kjo , do bëhet VKB.

Z.Arben Mexsi – Pse të mos vendosim disa skulptura , le të ketë një fond . Kemi shumë hapsira në rajon, për vendosjen e skulpturave.

Z.Sokol Kanani/Banor –

- Restaurimi i shkollës "Avni Rustemi"

-Problem , kanali nga ish Fabrika e Tullave - Çentrale – Lungomare ..., Zona po merr hov zhvillimi.

Z.Ermal Dredha – Faleminderit për kohën që konsumuam bashkë.

Faleminderit! Jam në dispozicion bashkë me administratën.

Vlorë, më 17.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Dëgjesë Publike

“ Mbi PBA 2024 ÷ 2026 dhe Projekt Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 “
Në Rajonin Nr 3. (Ora 16.30)

Marrin pjesë :

Deputetja znj.Pranvera Resulaj ;Kryetari i Bashkisë z.Ermal Dredha; Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj.Elpiniqi Mërkuri; Zëvendëskryetarë të bashkisë; Sekretari i KB; Anëtarë të Këshillit të Bashkisë ; Drejtorë drejtorish dhe institucionesh të bashkisë ; Kryetare e rajonit; Banorë të rajonit ; Shoqëria civile.

Znj.Manuela Prifti /Kryetare e rajonit – Faleminderit për pjesëmarrjen. Falënderoj kryetarin e bashkisë, deputeten, kryetaren e këshillit të bashkisë për prezencën e tyre. Do të zhvillojmë dëgjesën publike për buxhetin e vitit 2024. Do të kemi një bashkëbisedim të hapur.

Z.Ermal Dredha – Përshëndetje të gjithëve!

Më vjen mirë që pjesëmarrja është e lartë. Kemi filluar procesin e dëgjesave publike. Duhet të marrim patjetër mendimet tuaja, përveçse na i ngarkon ligji.

Marr shkas nga ky vit, kemi bërë një demarsh me FSHZH, kemi marrë dakortësinë për asfaltimin e disa rrugëve të qytetit, ku 3 ose 4 rrugë, i takojnë rajonit tuaj.

Jemi këtu për të dëgjuar kërkesat dhe sygjerimet tuaja.

Znj.Pranvera Resulaj/Deputete - Dominon, kjo pjesëmarrje..duam që kjo dëgjesë mos të jetë vetëm e realizuar, por të merren kërkesat dhe sygjerimet para hartimit të projekt buxhetit të vitit 2024. I kemi mbledhur të gjitha kërkesat e banorëve por, për të mos folur seicili prej tyre tani,, kryesisht kërkesat janë për rikualifikim , duan që disa prej tyre të bëhet rikualifikim i brendshëm. Kemi parashikuar një fond me kryetarin, kryesisht për rikualifikimin e brendshëm..Ka projekte për kopshte, për personat me aftësi të kufizuar etj..

Z.Hiqmet Haxhaj/DFBK - Në këtë dëgjesë publike jemi për hartimin e projekt buxhetit të bashkisë për vitin 2024, ku bazë për këtë është PBA (Programi Buxhetor Afatmesëm) 2024 – 2026 .

Treguesit kryesorë, janë :

Të ardhurat në Total – 2,659,506 (2miljard 659 mijë 506 mijë)

Përfshirë këtu investimet , në vlerën 377, 748 mijë lekë.

Prioritetet për Rajonin Nr 3 :

-Ndërtimi i shkollës “Lef Sallata”, ka qenë në buxhetin e vitit 2023, por fondi nuk ishte i mjaftueshëm dhe projekti mungonte.

-Rrjeti tercial i ujrave të zeza

-Rehabilitimi i lagjes “28 Nëntori “

-Rehabilitimi i lagjes “Dëshmorët “. Rehabilitimi i plotë nga bashkia, jo nga FSHZH.

Z.Ermal Dredha – Edhe Kopshti Nr 10.

Z.Hiqmet Haxhaj – Kopshti Nr 10, rehabilitim i pjesshëm.

Z.Klaudio Mehmetaj/D.Urbanistikës – Në vijim të diskutimeve, unë po vazhdoj me palestrën e shkollës “Lef Sallata “.., kemi kontaktuar dhe me FSHZH ..

-Projekti, me një fond prej 200 milion lekë/reja, do të ndërhyjmë dhe në fasadat e pallateve.

Kemi kërkuar financim nga FSHZH për asfaltimin e rrugës “Gjergj Araniti “ “Hasan Kushta”

Akset tek shkolla “Naim Frashëri “, gjithë rrugët lidhëse.

Këto janë miratuar dhe do fillojnë së shpejti.

Znj.Pranvera Resulaj - Ky është një draft , projekt buxhet. Qëllimi është të marrim më emergjentet .

Z.Klaudio Mehmetaj – Çka ngel në mes, gjysma e palestrës së shkollës “Lef Sallata “

Projekti për Kopshtin Nr 10, rikonstruksioni i ambjenteve, ka nevojë për shtretër, rritja e kapacitetit, përfshirë këtu dhe sistemin e ngrohjes dhe ftohjes...Të dëgjojmë problematikat tuaja.

Znj.Negime Pulaj/Banore – Problemi i ujit të pijshëm, me orar pa orar. Ujin e blejmë, rëndon në xhepat e qytetarëve.

-Problem rruga “Varrosh “, është e dëmtuar, pra rruga që lidh rrugën” Varrosh” me shkollën “Musa Çakërr”, vetëm baltë.

-Kanalizimet, Ujësjiellësi me riparimet që bën ...Brenda në Varrosh, jetojnë rreth 15 familje në baraka, është një geto.

-Ndërtimet, bllokojnë rrugët lidhëse, është cilësi, infrastrukturë shumë e keqe.

-U ngritën 2 tregje, ishin modestë, për fat të keq u shkatërruan para 8 vjetësh. Tregëtarët i shesin në rrugë produktet.

-Rajoni ka numër të madh banorësh, por sipërfaqe të vogël. Të bëhet një projekt pilot . Të bëhen rrugët përreth pallateve. Kjo gjendje , është dhe mbas “3 Racave “

-Pastrimi, gjelbërimi, funerali, nuk janë në gjendje normale. Të shtohen sipërfaqet. Nëpër pallate janë vendosur koshat.

-Rast i veçantë, familja Mbole, shtëpi e përmbytur. Kryetare e rajonit tha se do bëhej, por nuk u bë gjë.

-Të ndërthuren problematikat midis këshilltarëve dhe banorëve.

Z.Eduart Banushi/ Banor ,lagja “28 Nëntori”- Ka mungesë koshash ku banoj unë.

-Rruga që del në Transballkanike, kur bëhen pallatet e rinj, zhduken kazanët.

-Është një gabinë elektrike.

